



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNËS - SHTIME
Komiteti për Politikë dhe Financa
Nr.01-060/01-8114/21 datë: 06.04.2021



Npi – 01/121 datë: 16.04.2021

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040; Si dhe në bazë të nenit 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi-01/114 të datës: 26.04.2019, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më: 16.04.2021 nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -IV- TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA
E mbajtur më datën: 16.04.2021 (e premte) në ora 10.00 h. në sallën Nr.1 të Kuvendit

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesja znj.Medina Brahaj, pastaj anëtarët e Komitetit z.Perparim Ramusa, z.Naim Zejna, znj.Zarife Rexhaj, z.Ruzhdi Jashari dhe znj.Adelina Beqaj. Përveç anëtarëve të KPF-së në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: Drejtorët.

Mbledhjen e hapi, Kryesuesja e KPF-së znj.Medina Brahaj, e cila pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Për këtë mbledhje është propozuar ky:

REND DITE

1. Shqyrtimi për miratimin përfundimtar për dhënien në shfrytëzim për 99 vite, pjesën e parcelës nr. P-72809029-00230-0 me sipërfaqe prej 35231m2, në zonën kadastrale Dugë te vendi i quajtur “Kodra e Mustabashit”, dhe parcelën me nr. P-72809029-00251-0 me sipërfaqe prej 3859m2, në zonën kadastrale Dugë te vendi i quajtur “Ahishte për mbi shpi”.
2. Propozim-Vendim për këmbim të pronës së paluajtshme komunale, sipas vendimit të Kuvendit Npi-01/272, të datës 24.11.2020,
3. Propozim-Vendim për shpalljen me interes publik të ngastrave kadastrale Rancë, Nr.372/0, 373/0, pronë e Salih Halili dhe Shaban Halili — Rancë,
4. Propozim-Vendim për ndryshim të destinimit të shkollës dhe oborrit të shkollës në Llanisht,
5. Caktimi i lokacionit për vendosjen e shtatores së Adem Jasharit,
6. Informatë e përgjithshme nga drejtoria për Inovacion.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Para se të hapi diskutimin për rendin e ditës, Kryesuesja e njoftoi Komitetin për shtyrjen e e mbledhjes nga data 12.04.2021 për datën 16.04.2021, dhe se Ekstrakt Procesverbal nga mbledhja më 20.11.2020, nuk është gati. Kryesuesja po ashtu propozoi që të hiqet pika 6 e rendit të ditës me arsyetimin se është kërkuar Informacion nga Drejtoria për Inovacion dhe se është vendosur gabimisht në rend dite si pikë. Ky propozim u aprovua dhe në vazhdim u zhvilluan diskutimet e tjera lidhur me rendin e ditës.

z.Naim Zejna; Propozoj që pikat lidhur me pronat në Rancë dhe Dugë të hiqen nga rendi i ditës pasi që jemi në vitin elektorat. Nuk është e arsyeshme t'i japim këto prona në këtë mënyrë pasi që do të reflektojnë keq edhe te qytetarët.

z.Perparim Ramusa; Jemi në fazën kur tre muaj ka punuar komisioni. Ofertat janë dhënë dhe kanë aplikuar ata që kanë dashur. Pajtohem që vetëm pika 6 të hiqet nga rendi i ditës.

z.Ruzhdi Jashari; Plotësisht pajtohem me propozimin e Naim Zejnës sepse jemi në vitin elektorat. Kërkoj që të hiqen nga rendi i ditës pikat që kanë të bëjnë me dhënien e pronave. Ky është një keqpërdorim nëse marrim vendim për dhënie të pronave tani kur dihet se kemi një plan pune që duhet t'i përmbahemi. Kërkoj të hiqen nga rendi i ditës këto pika.

z.Naim Zejna; Është e natyrshme t'i shqyrtojmë edhe këto pika, por jemi në vitin elektorat. Dallon pika parë me pikat e tjera për pronat. Sa i përket aplikacioneve, për këtë prone, është e qartë që kjo është dakorduar paraprakisht. Kërkoj që pika 1 dhe 3 të hiqen nga rendi i ditës.

z.Perparim Ramusa; Nëse jemi në afatë ligjore atëherë duhet t'i shqyrtojmë edhe pikat e propozuara ashtu si janë në rend dite.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoj kuorumin prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje.

Komiteti për Politikë dhe Financa, me 4 vota “ për “ (me votën e dyfishtë të Kryesueses) me 3 vota “Kundër”, dhe me 0 vota “Abstënim” aprovoi Rendi i Ditës duke e hequr pikën 6.

Pika 1

Shqyrtimi për miratimin përfundimtar për dhënien në shfrytëzim për 99 vite, pjesën e parcelës nr. P-72809029-00230-0 me sipërfaqe prej 35231m², në zonën kadastrale Dugë te vendi i quajtur “Kodra e Mustabashit”, dhe parcelën me nr. P-72809029-00251-0 me sipërfaqe prej 3859m², në zonën kadastrale Dugë te vendi i quajtur “Ahishte për mbi shpi”.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Ruzhdi Jashari; Unë kërkoj sqarim nga Komisioni se mbi cilat argumente ka punuar, kur dihet se dhënia e pronave në shfrytëzim është në kundërshtim me Rregulloren e vitit 2020, pastaj nuk e kemi as listën e pronave për 2020 të aprovuar paraprakisht.

z.Naim Zejna; Nga materiali shihet se është një vijë që përshkon autostradën që ka qenë propozim i mëhershëm. Aty nuk ka siguri për investimin, në shumën e deklaruar. Nuk ka nevojë për investim në Dugë dhe nuk është i sigurtë ky investim. Është investim i dyshimtë këtu.

z.Perparim Ramusa; Është propozim i opozitës për anëtarët e komisionit që kanë punuar.

Tani kemi një Plan-ofertë për investim dhe punësim të 28 punëtorëve. Ligji e përcakton qartë çka duhet të ndërmerret nëse nuk bëhen investime në afatin e paraparë. I besoj Komisionit dhe jam që t'i epet prona ashtu si e ka përcaktuar Komisioni.

z.Ruzhdi Jashari; Po e potencoj prapë se ky marifet i pronave është në kundërshtim me Rregulloren e muajit gusht 2020. Pastaj nuk e kemi listën e aprovuar nga 2020-ta, prandaj jam kundër që të jepet kjo pronë.

z.Naim Zejna; Komisioni ka vendosur mbi bazën e fakteve të prezantuara. Nuk ka garancion apo është garancion-deklarim verbal për investimin e 980.000€. Është në pyetje vija e autostradës e cila herëdokur do të kalojë andej. Pse nuk jepet kjo prone njëherë për 10 vjet e pastaj t'i vazhdohet, e jo për 99 vjetë menjëherë, pa pasur siguri për investime. Unë jam kundër dhënies së kësaj prone kështu si po kërkohet.

znj.Zarife Rexhaj; Fshati Dugë është pitoresk dhe i përshtatshëm për turizëm. Nëse është investim serioz është mirë, por kam dyshimet e mia dhe jam kundër.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoj kuorumin prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje.

Komiteti për Politikë dhe Financa, me 4 vota “për” (me votën e dyfishtë të Kryesueses) me 3 vota “kundër”, dhe me 0 vota “Abstënim” vendosi t'i rekomandojë Kuvendit aprovimin e vendimit përfundimtar për dhënien në shfrytëzim për 99 vite, pjesë të parcelave, nr. P-

72809029-00230-0 me sipërfaqe prej 35231m², në zonën kadastrale Dugë te vendi i quajtur “Kodra e Mustabashit”, dhe parcelën me nr. P-72809029-00251-0 me sipërfaqe prej 3859m², në zonën kadastrale Dugë te vendi i quajtur “Ahishte për mbi shpi”.

Pika 2

Propozim-Vendim për këmbim të pronës së paluajtshme komunale sipas Vendimit të Kuvendit Npi-01/272, date 24.11.2020

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Fillimisht ka dhënë sqarimin lidhur me këtë pikë duke bërë të ditur se është dakorduar me grupet parlamentare që të bëhen ndryshimet e propozuara sipas Propozim-Vendimit për këmbim të pronës së paluajtshme komunale, sipas vendimit të Kuvendit Npi-01/272, të datës 24.11.2020. Në vazhdim hapi dislutimin për këtë pikë.

z.Naim Zejna; Ne grupi parlamentar i LDK-së jemi që në Kuvend të mos vie asnjë pikë lidhur me pronat. Kjo ka mbetur kështu, po ashtu kemi propozuar që prona lidhur me Sali Beqën të kthehet në pikën zero dhe ai ta mbajë pronën në Lagje të Pajtimit, si ka qenë. E dime si është përfutur ajo prone. Atë ditë kemi thënë që Vendimi, që t'i epet STN-së, Sadik Abazit, të shqyrtohet dhe nga pjesa e mbetur t'i jepet Salih Beqës, në atë lokacion. Parcela që i është dhënë Sadik Abazit të bashkohet me atë të Salih Beqës. Në kuadër të vendimit ka zbrazëtirë në mes.

z.Perparim Ramusa; Unë propozoj që t'i rekomandojmë Kuvendit marrjen e vendimit ashtu si jemi marrë vesh në takimin që kemi pas. Kompensimi i pronës me ngastrën Nr.333 të kompensohet me ngastrën numër Nr.334.

z.Ruzhdi Jashari; Komuna ka obligim që të bëjë kompensime sipas Rregulloreve. Në Davidovc është e vetmja prone që ka Komuna në pronësi. Komuna ka intertesa të tjera që duhet t'i realizojë. Dhënia e pronave është bërë rutinë. Prona e Salih Beqës të kthehet në pikën zero. Edhe prona që i është dhënë Sadik Abazit është e dyshimtë.

znj.Zarife Rexhaj; Si anëtarë të Kuvendit, në takimin e mbajtur, është dashur të arrihet dakordim e jo të diskutojmë vazhdimisht për këtë çështje. Nëse vie te fuzionimi i pronave në Davidovc, unë jam pro.

z.Naim Zejna; Prona Nr.333-2 dhe prona Nr.333-3 ne nuk e dime se sa i është dhënë, 1 ha e 2 ari apo më shumë. Si grup konsultativ kemi diskutuar, por KPF-ja duhet ta japë mendimin e vet për Kuvendin. Sali Beqa ka 1ha e 284m katrorë që i jepen nga Sadik Abazi. Kështu ka qenë.

z.Perparim Ramusa; Diskutimet janë të tepërta sepse sipas dokumentit të propozuar nga grupet parlamentare është përcaktuar edhe sipërfaqja edhe vendi.

z.Ruzhdi Jashari; Parimisht ato prona duhet të lirohen sepse janë të vetmet prona Komunale. Tash krahas pronave të tjera që kanë përfutur ata, tani duhet prapë t'ju japim prona Komunale, jashtë rregullave. Këta janë hapa të gabuar që po diskutojmë. Ne jemi këtu dhe vendosim, dhe jo grupet konsultative.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Kuvendi nuk ka pasur mundësi të marrë vendim për këtë pikë për shkak se janë kërkuar sqarime që i kemi dhënë tani më. Pas diskutimeve konstatoi kuorumin prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje.

Komiteti për Politikë dhe Financa, me 5 vota “Për me 1 votë “Kundër” dhe me 0 vota “Abstënim” vendosi ti rekomandojë Kuvendit që të aprovojë Vendim për këmbim të pronës së paluajtshme komunale, sipas vendimit të Kuvendit Npi-01/272, të datës 24.11.2020. Në këmbim të përfshihet komplet parcela me numër P-333/3 dhe pjesa e mbetur të merret nga P-333/4 (të filllohet në kujinj të parcelës fqinje STN “ Betoni “) dhe i adresohet MEF-it, Departamentit për vlerësim, për procedim tutje.

Pika 3

Propozim-Vendim për shpalljen me interes publik të ngastrave kadastrale Rancë, Nr.372/0, 373/0, pronë e Salih Halili dhe Shaban Halili — Rancë

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Fillimisht Kryesuesja elaboroi Propozim-Vendimin për shpalljen me interes publik të ngastrave kadastrale Nr.372/0, 373/0, pronë të Salih Halili dhe Shaban Halili — Rancë, Zona Kadastrale – Rancë dhe pastaj hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Naim Zejna; Qasja-rruga është për të gjithë. Parcela 372/0 dhe 373/0, ka nevojë të shpronësohet sepse pengon qasjen deri te Shtabi i UÇK-së.

z.Ruzhdi Jashari; Duhet të bëhet një pike përkujtuese e Shtabit të UÇK-së, në Rancë. Aty kemi dy shtëpi. Njëra është rrënuar e tjetra para rrënimit. Aty nuk ka banuar askush. Shpronësimi duhet të bëhet te shtëpitë. Duhet formuar një komision për këtë nga veteranët. Shpronësim po, por çfarë shpronësimi.

znj.Zarife Rexhaj; Sa i kushton Komunës ky shpronësim? Nëse është qasje për te Shtabi i UÇK-së, unë e mbështes këtë shpronësim.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoj kuorumin prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje.

Komiteti për Politikë dhe Financa, me 4 vota “Për”, me 1 votë “Kundër” dhe me 1 votë “Abstenim” vendosi ti rekomandojë Kuvendit që ta aprovojë Vendimin për shpalljen me interes publik të ngastrave kadastrale Rancë, Nr.372/0, 373/0, pronë e Salih Halili dhe Shaban Halili — Rancë.

Pika 4

Propozim-Vendim për ndryshim të destinimit të shkollës dhe oborrit të shkollës në Llanisht

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Edhe për këtë Propozim-Vendim për ndryshim të destinimit të shkollës dhe oborrit të shkollës në Llanisht, sqarime dha Kryesuesja. Pastaj hapi diskutimin.

z.Naim Zejna; Në shkollën në Llanisht, duhet të vendoset një tablë që tregon se ka qenë pjesë e Shtabit të UÇK-së. Jo të ndryshohet destinimi, por të shfrytëzohet nga të rinjtë. Ajo duhet të mbetet pronë Komunale.

z.Ruzhdi Jashari; Objektet si kjo shkollë duhet të mbeten si trashëgëmi e luftës së UÇK-së. Kjo qasje për ndryshim destinimi është jo serioze. Duhet të pytet Drejtoria e Arsimit se a i nevojitet ky objekt. Ai objekt është shfrytëzuar nga ushtarët e UÇK-së. Aty ka një aneks që mund të shfrytëzohet nga ata që e kërkojnë.

z.Perparim Ramusa; Kërkesa është pikërisht për rekreacion. Aty nuk ka mirëmbajtje prandaj edhe kërkohet nga Shoqatat që ta ketë dikush në menagjim.

z.Naim Zejna; Nuk kemi nevojë të bartim këtë prone në emër të dikujt. Aty nevojitet një pllakë përkujtimore që tregon se objekti ka qenë në shërbim të UÇK-së.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Pas diskutimeve lidhur me këtë pikë, Kryesuesja konstatoi kuorumin prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje.

Komiteti për Politikë dhe Financa, me 3 vota “Për”, me 1 votë “Kundër” dhe me 2 vota “Abstenim”, vendosi ti rekomandojë Kuvendit që të marrë vendim sipas propozim-Vendimit të shtruar.

Pika 5

Caktimi i lokacionit për vendosjen e shtatores së Adem Jasharit.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Sa i përket Propozimit të DKRS-së për caktimin e lokacionit për vendosjen e shtatores së Adem Jasharit, sqarime dha Kryesuesja, dhe në vazhdim hapi diskutimin.

z.Perparim Ramusa; Të dy lokacionet e propozuara janë të papërshtatshme. Propozoj këtë çështje ta diskutojmë më mirë në Kuvend.

znj.Zarife Rexhaj; Propozimi te Trekëndëshi është hapësirë e ngusht prandaj le të diskutojmë më gjërësisht në Kuvend.

z.Ruzhdi Jashari; E përkrahim iniciativën, por duhet gjetur vendin që korespondon me madhësinë e figures së “Adem Jasharit”. Duhet diskutuar edhe me publikun për këtë çështje. Vendi më i mirë është rrënimi i objektit para Komunës dhe vendosja e shtatores. Le ta shpronësojë Komuna këtë objekt për vendosjen e shtatores së Komandantit “Adem Jashari”.


z.Naim Zejna; Pajtohem me konstatimet e parafolësve. E mirëpresim vendosjen e shtatores. Aq shumë po japim prona sa që nuk po na mbetet vend as për një shtatore. Në qendër të trekëndëshi nuk ka hapësirë, por as lokacioni tjetër nuk është i përshtatshëm, por është më i mirë.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoj kuorumin prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht, vendosi t’i rekomandojë Kuvenditi që të diskutojë lidhur me këtë dhe të vendosë për lokacionin më të përshtatshëm që konsideron për vendosjen e shtatores së Adem jasharit.**

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Pasi që diskutime tjera nuk kishte, Kryesuesja, mbledhjen e përfundoi në ora 12.30h.

Procesmbajtësi:
Ibrahim Demiri



Kryesuesja e KPF
Medina Brahaj

